



VENDIM

Nr.1 Datë 20.01.2010

PËR

**LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “CEZ TRADE ALBANIA” SH.P.K
NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “a”, 9 dhe 13, pika 1, germa “d”, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, dhe nenit 4 pika 1, germa “g”; neneve 5, 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108 datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 20.01.2010, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k për liçensim në aktivitetin e Tregëtimit të Energjisë Elektrike,

Dhe konstatoi se :

- Fillimi i procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “CEZ Trade Albania” sh.p.k ka nisur me marrjen e vendimit Nr. 84, dt.04.11.2009.
- Dokumentacioni për aplikimin për liçensimin për kryerjen e aktivitetit të tregëtimit të energjisë elektrike është paraqitur i plotë konform përcaktimeve të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të liçensojë shoqërinë “CEZ Trade Albania” sh.p.k në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike me afat të vlefshmërisë së liçensës 5 vjet.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE-s
Bujar Nepravishta